

AKTIVITETE NË KUADËR TË DITËVE NDËRKOMBËTARE

- Në kuadër të **“Tetorit Rozë”** u zhvillua aktiviteti *“Hapat që ndërgjegjësojnë”* me qëllim ndërgjegjësimin e grave dhe vajzave për rëndësinë e vetëkontrollit të gjirit dhe kujdesit ndaj shëndetit.
- Në kuadër të **“Tetorit Rozë”**, në bashkëpunim me Këshillin Rinor u organizua aktiviteti i shpërndarjes së fjongove dhe fletëpalosjeve ndërgjegjësuere për vajzat dhe gratë në qytetin e Kamzës.
- Në kuadër të **“Tetorit Rozë”** u dhanë mesazhe sensibilizuese nëpërmjet një videoje, pjesë e së cilës ishin gra dhe vajza; nga fusha të ndryshme.
- Në kuadër të **“Ditës Ndërkombëtare të përkujtimit të Holokaustit”**, me mbështetjen e UNDP-së, UNFPA-së dhe Youth Voice Network of Organizations u zhvillua teatri multimedial *“Babo Kujton gjenocidin”* me të rinjtë e qytetit (gjimnazeve & KVR).
- Në kuadër të **“Ditës Botërore të Tokës”** u zhvillua një aksion pastrimi me rreth 300 të rinj përreth zonës së gjimnazit *“Ibrahim Rugova”*.
- Në kuadër të **“Ditës Evropiane të Solidaritetit ndërmjet brezave”**, me të vegjlit e kopshtit *“Borëbardha”*, u zhvilluan disa aktivitete (mbjellje fidanësh, punime dore, lojëra, gatime).
- Në kuadër të **Javës së Evropës 2024 *“BE për përfshirjen, diversitetin dhe të drejtat e njeriut”***, u pikturua muralja #Evropaështekëtu, në zonën e Parkut të Liqenit të Paskuqanit.
- Në kuadër të **Javës së Evropës 2024 *“BE për përfshirjen, diversitetin dhe të drejtat e njeriut”***, u zhvillua aktiviteti *“Harmonia Evropiane: Koncert, ekspozitë dhe panair nën temat e përfshirjes, diversitetit dhe të drejtave të njeriut”*.
- Në kuadër të **“Ditës Botërore të Bicikletave”**, rreth 30 nxënës nga 3 gjimnazet e Bashkisë Kamëz (Isa Boletini; Jashar Hoxha; Ibrahim Basha), pedaluan përgjatë Parkut të Liqenit të Paskuqanit, me qëllim dhënien e mesazheve për sensibilizimin në përdorimin e bicikletave, si mjeti më ekologjik i transportit.
- Në kuadër të **“Ditës Botërore të Mjedisit”**, u zhvillua aktiviteti me fëmijët e disa prej kopshteve (Kopshti *“Xixëllonjat”*, Valias, Kopshti *“Topolino”*, Zall Mner, Çerdhja Nr.3 Dritë, Valias) të Bashkisë Kamëz.
- Në kuadër të **“Ditës Botërore të Mjedisit”**, në ambientet e shkollës 9-vjeçare *“Dom Nikollë Kaçorri”*, u zhvillua aktiviteti me të rinjtë e shkollës dhe stafin administrativ, në formën e një panairi me materiale të riciklueshme, ku nxënësit prezantuan punimet e tyre për të pranishmit.
- Në kuadër të **Javës së Evropës 2025 *“BE për përfshirjen, diversitetin dhe të drejtat e njeriut”***, u zhvilluan ekspozita dhe panairë kulturore ku kishte për qëllim promovimin e vlerave kulturore në Kamëz. U vendosën disa stenda me veshje kombëtare, produkte antike dhe artizanale, puntori krijuese nga të rinjtë, materiale informuese mbi BE-në, performance me këngë e valle nga grupi I pallatit të kulturës *‘Artan Cuku’*.